



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:097266

Datë: 14.12.2023

Numri i dokumentit: 05063548

Ep.nr.122/2022

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtarja Blerta Kelmendi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit K... “A.....”, SH.A, me adresë rruga ”Xh... S” Fusha e Pejës, rr: T....., në Pejë, ndaj debitorit Y (J) K, me adresë në rruga: “A e B. Gj”, p.n, Pejë, me bazë juridike përmbartimore pagesa e borxhit në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit kundër Urdhrit të Përmbartuesit Privat Blerim Baloku, me seli në Pejë, P.nr./I.Br.2142/19, i datës 15.11.2019, jashtë seancës gjyqësore, me datë 14.12.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET PJESËRISHT SI I BAZUAR, prapësimi i debitorit Y (J) K, me adresë në rruga: “A e B Gj”, p.n, Pejë, ashtu që SHFUQIZOHET pjesërisht Urdhri i Përmbartuesit Privat Blerim Baloku, me seli në Pejë, P.nr./I.Br.2142/19, i datës 15.11.2019, sa i përket shumës së borxhit në lartësi prej 206.05 euro.

II.REFUZOHET I PABAZUAR, pjesa tjetër e prapësimit të debitorit dhe MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor i Përmbartuesit Blerim Baloku, me seli në Pejë, P.nr./I.Br.2142/19, i datës 15.11.2019, sa i përket shumës prej 106.95 euro.

A r s y e t i m

Kreditori K “A.....”, SH.A., me seli në Pejë, me datë 15.11.2019, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm- ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve të bartjes së mbeturinave, për periudhën kohore nga data 01.02.2008 e deri më 31.10.2019, në shumën prej 313.00 euro.

Përmbaruesi Privat duke vendosur në bazë të propozimit të kreditorit, ka nxjerrë Urdhrin P.nr./I.Br.2142/19, i datës 15.11.2019, duke lejuar përmbarimin e propozuar.

Debitori në afatin e lejuar ligjor, me datën 22.03.2022, ka parashtruar prapësim kundër këtij urdhri përmbarimor, me arsyetimin se kërkesa e kreditorit për borxhin që nga data 01.02.2008 e deri me 21.10.2019, është parashkruar në kuptim të nenit 360 të LMD-së, pasi që kanë kaluar me shumë se 12 vite nga viti 2008, e po ashtu edhe nga data e fundit e vitit 2019, duke i propozuar gjykatës që ta anuloj urdhrin përmbarimor ndërsa prapësimin ta aprovoj si të bazuar. Kreditori lidhur me pretendimet në prapësim nuk ka dhënë përgjigje në prapësim.

Gjykata në procedurën përmbarimore pasi ka shqyrtuar dhe vlerësuar prapësimin e palës debitore, si dhe shkresat e tjera të lëndës, ka gjetur se prapësimi është *pjesërisht i bazuar*.

Shqyrtimi i ligjshmërisë të urdhrin përmbarimor dhe dokumentit të besueshëm.

Në propozimin për përmbarim të kreditorit të datës 15.11.2019, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Blerim Baloku, me seli në Pejë, P.nr./I.Br.2142/19, i datës 15.11.2019, në bazë të dokumentit të besueshëm-ekstrakti nga librat afariste, nga ana e kreditorit është kërkuar borxhi për periudhën kohore nga data 01.02.2008 e deri më 31.10.2019, në shumën prej 313.00 euro, në emër të bartjes së mbeturinave.

Gjykata pas vlerësimit të dokumentit të besueshëm-ekstraktit nga librat afariste, mbi bazën e të cilit është filluar procedura përmbarimore, konsideron se i ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore në kuptim të dispozitës së nenit 29 par.1 pika 1.2 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (tutje LPP-së), që përcakton shprehimisht se: *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.1. kambialet dhe çeqet me potest dhe faturë kthyese, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës; 1.2. ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*.

Në këtë drejtim, dokumenti i besueshëm, mbi bazën e së cilit është aprovuar edhe urdhri për përmbarim është i ligjshëm dhe në harmoni me par.3 të nenit 29 të LPP-së, që përcakton se *“Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata pas konstatimit të ligjshmërisë të urdhrimit përmbartimor, gjen se prapësimi i debitorit se kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës së kreditorit për arkëtimin e borxhit në rrugë gjyqësore, është pjesërisht i bazuar, konform nenit 378 par.1 të LMD-së së ish-RSFJ-së dhe nenit 360 par.1 të LMD-së.

Gjykata parashkrimin e borxhit për periudhën nga 01.02.2008 e deri më 18.12.2012, ka zbatuar dispozitat e LMD-së të ish RSFJ-së (i vitit 1978), si ligj në fuqi në kohën kur është krijuar marrëdhënia juridike civile, kurse nga 19.12.2012 e tutje, gjykata ka zbatuar dispozitat e Ligjit nr.04/L-077- të Marrëdhënieve të Detyrimeve (të vitit 2012). Gjykata konstaton se kreditori për një pjesë të kërkesës ka humbur afatin ligjor brenda të cilit do të mund të arkëtonte forcërisht borxhin përmes rrugës gjyqësore, saktësisht për borxhin që përfshin periudhën kohore nga data 01.02.2008 e deri më 31.12.2017, në shumë prej 206.05 euro për shkak të parashkrimit.

Kreditori propozimin për përmbartim, e ka paraqitur më datën 15.11.2019 dhe sipas vlerësimit të gjykatës, borxhi i krijuar nga ana e debitorit që nga data 01.02.2008 e deri më 31.12.2017 është parashkruar, sepse ka kaluar afati 1 vjeçar brenda së cilës kreditori ka pasur mundësi të kërkojë përmbushjen gjyqësore të detyrimit, referuar nenit 378 të LMD-së të ish-RSFJ-së: *“Parashkruhen për një vjet: kërkesa e kompensimit për livrimin e energjisë elektrike e të ngrohjes, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e pastërtisë, kur livrimi, respektivisht shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”* dhe nenit 360 par.1 pika 1.1 dhe par.2 dhe 3 të LMD-së që përcakton se *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: 1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake; 2. Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë. Kurse neni 341 par.1 i LMD-së përcakton se “Me parashkrim shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit.”*

Sa i përket rrjedhshmërisë së afatit të parashkrimit, tek këto kërkesa, afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë. Në rastin konkret parashkrimi i borxhit nga data 01.02.2008 ka filluar të rrjedhë në fund të vitit, respektivisht më 31.12.2008, ndërsa është parashkruar pas një viti respektivisht me 31.12.2009.

Nën të njëjtin arsyetim të rrjedhjes së parashkrimit, parashkrimi i borxhi i vitit 2009, ka filluar të rrjedhë në fund të vitit 2009, respektivisht me 31.12.2009, ndërsa është parashkruar me

31.12.2010. Parashkrimi i borxhit të vitit 2010, ka filluar të rrjedhë në fund të vitit 2010, respektivisht, me 31.12.2010, ndërsa është parashkruar me 31.12.2011. Parashkrimi i borxhit të vitit 2011, ka filluar në fundin e 2011, ndërsa i njëjti është parashkruar me 31.12.2012. Parashkrimi i borxhit të vitit 2012, ka filluar të rrjedhë në fundin e 2012, ndërsa i njëjti është parashkruar me 31.12.2013.

Parashkrimi i borxhit të vitit 2013, ka filluar të rrjedhë në fund të vitit 2013, ndërsa është parashkruar me 31.12.2014.

Parashkrimi i borxhit të vitit 2014, ka filluar të rrjedhë në fund të vitit 2014, ndërsa është parashkruar me 31.12.2015.

Parashkrimi i borxhit të vitit 2015, ka filluar të rrjedhë në fund të vitit 2015, ndërsa është parashkruar me 31.12.2016.

Parashkrimi i borxhit të vitit 2016, ka filluar të rrjedhë në fund të vitit 2016, ndërsa është parashkruar me 31.12.2017.

Parashkrimi i borxhit të vitit 2017, ka filluar të rrjedhë në fund të vitit 2017, ndërsa është parashkruar me 31.12.2018.

Kurse, propozimi për përmbarrim nga kreditori është paraqitur me 15.11.2019, që në kuptim të nenit 360 par.1 të LMD-së, kreditori për këtë periudhë kohore, propozimin për përmbarrim e ka paraqitur jashtë afatit ligjor 1 vjeçar, me ç'rast, borxhi i krijuar për vitet 01.02.2008 e deri më 31.12.2017, në shumën e përgjithshme prej 206.05 euro është parashkruar.

Vendosja si në pikën II të dispozitivit të aktvendimit.

Gjykata konstaton se debitori detyrohet ti paguaj kreditorit shumën prej 106.95 euro për heqjen e mbeturinave, për periudhën kohore nga 01.01.2018 e deri më 31.10.2019, për shkak se borxhi i tillë për këtë periudhë nuk është parashkruar.

Kreditori me paraqitjen e propozimit për përmbarrim të datës 15.11.2019, e ka ndërprerë parashkrimin e borxhit për periudhën kohore të lartcekur nga data 01.01.2018 e deri më 31.10.2019. Kjo për shkak se parashkrimi i borxhit i vitit 2018 ka filluar të rrjedhë në fund të këtij viti, pra me 31.12.2018 dhe borxhi i këtij viti do të parashkruhej pas një viti, respektivisht me 31.12.2019, kurse kreditori propozimin për përmbarrim e ka paraqitur me datën 15.11.2019, brenda afatit ligjor 1 vjeçar, të paraparë me nenin 360 par.1 të LMD-së. Paraqitja e propozimit ka ndërprerë parashkrimin e borxhit në kuptim të nenit 369 par.1 të LMD-së, që përcakton se: *“Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të*

ndërmarrur kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”.

Për këtë pjesë të detyrimit, gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të aktvendimit, dhe debitori detyrohet që shumën prej 106.95 euro t’ia paguaj kreditorit.

Gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancën gjyqësore dhe atë referuar vendimit të GJEDNJ-së *Saccoccia kundër Austrisë* (Aktgjykim i datës 18 dhjetor 2008), pasi pretendimet e palëve kanë qenë qarta dhe të njëjtat ngërthenin çështje ekskluzivisht ligjore të cilat nuk e kanë bërë të domosdoshme mbajtjen e seancës publike, në ndërlidhje edhe me natyrën jo komplekse e çështjes, gjykata u bazua në nenin 73 paragrafi 1 të LPP-së, i cili përcakton se: *“Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përjashtimisht gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit”.*

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 29 par. 1 nënpar.2, nënpar.3 dhe par.3 lidhur me nenin 73 dhe nenit 77 par.1 dhe 5 të LPP-së, nenit 378 par.1 të LMD-së së ish-RSFJ-së dhe nenit 360 par.1 dhe 2, lidhur me nenin 369 të LMD-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL

2022:097266

Ep.nr.122/2022, me datë 14.12.2023.

G j y q t a r j a

Blerta KELMENDI

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes Gjykatës Themelore në Pejë.